



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2025:001278
Datë: 07.02.2025
Numri i dokumentit: 06817521

P.nr.06/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.I. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale *Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 367 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1391/23 e datës 08.01.2025, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 05.02.2025, në praninë e prokurorit të shtetit Vyrtyte Gërvalla, të pandehurit A.I. dhe avokatit mbrojtësi sipas autorizimit av.Rifat Bllata, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 05.02.2025, me datë 07.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.I., nga i ati I..., e ëma L..., e vajzërisë K..., data e lindjes..., në fshatin ... komuna e Vushtrrisë, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, student në fakultetin e shkencave kompjuterike AAB, me numër personal të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 02.08.2023, rreth orës 21:00, në fshatin Stanofc i Epërm në Vushtrri, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët mban në pronësi, posedim dhe kontroll armën e llojit Ekol Special 99, me nr. serik EV-16121109, një karikator të zbrazët të kësaj arme dhe një gëzhhojë të kalibrit 9 mm, të cilat i pandehuri i ka dorëzuar vullnetarisht te Policia e Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II. SEPSE: Më datë 02.08.2023, rreth orës 20:50, në fshatin Stanofc i Epërm në Vushtrri, i pandehuri gjatë një ahengu familjar përdor armën e llojit Ekol Special 99, me nr. serik EV-

16121109, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm mbi armët, duke shtënë me të një herë në ajër, ku gëzhoja e shkrepur e armës së lartcekur është gjetur dhe sekuestruar nga Policia e Kosovës.

- Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 366 par.1 dhe 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIN A.I.:

I. Për veprën penale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej tetëqind (800) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Për veprën penale të përshkruar si në pikën II të dispozitivit i shqipton DENIM ME BURG në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve.

Në rast se i pandehuri refuzon ose nuk mundet të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i armës – e llojit Ekol Special 99, me nr. serik EV-16121109, një karikator i zbrazët i armës dhe një gëzhjojë e kalibrit 9 mm.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqindë euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1391/23 e datës 08.01.2025 kundër të pandehurit A.I. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 05.02.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri A.I. ka deklaruar se e

pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

Prezantimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga këtu i pandehuri, për të dy veprat që i vihen në barrë, pasi që ky deklarim i tij gjen mbështetje edhe në provat që e mbështesin aktakuzën, ashtu që në rast se gjykata e aprovon fajësinë të njëjtit ti merret si rrethanë lehtësuese, ky fakt pra pranimi i fajësisë të i merret rrethanë tjetër lehtësuese fakti se i pandehuri asnjëherë me parë nuk ka ra ndesh me ligjin, premtimi i tij që nuk do të përsëris më vepër penale, ndërsa si rrethanë renduese të merret rrezikshmëria që mund të rezultojë nga këto vepra penale me theks të veçantë për veprën penale nga pika II e dispozitivit pasi që i pandehuri kur ka gjuajtur me armë, këtë e ka bërë në një ambient ku kanë qenë të pranishëm edhe persona të tjerë, çka ka mundur të rezultojë me pasojë tjetër nga ajo që ka rezultuar në gjendjen faktike.

Avokati mbrojtës i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë, ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, i njëjti ka shprehur keqardhje, është thellë i penduar, por në ditën kritike një armë të cilën e ka pasur me gaz e ka përdorur duke shtënë një herë me të vetmin plumb që e ka poseduar, dhe atë në shenjë gëzimi me rastin e martesës së vëllait të tij. I mbrojturi i tij në kohën kur e ka kryer veprat po sa i kishte mbushur 18 vite, andaj i propozon gjykatës që edhe këtë ta merr si rrethanë lehtësuese

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-BD-659, i datës 02.08.2023, raporti i policit, i datës 02.08.2023, shënimi zyrtar i hetuesit, i datës 02.08.2023, raporti i shpejt policor, i datës 03.08.2023, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.I., i datës 02.08.2023, vërtetimi mbi armën e konfiskuar, i datës 02.08.2023 dhe fotoalbumi në shtojcë prej 4 fotografive, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Në nenin 367 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm e kryen “*Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet*.”

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve të nenit 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana posaçërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, mosha e të pandehurit, dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë. Po ashtu gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese edhe rrethanat personale të të pandehurit, përkatësisht faktin se i njëjti është student dhe vijon studimet bachelor në lëmin shkenca kompjuterike ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur rrezikshmërinë shoqërore që paraqesin këto vepra penale e posaçërisht duke pasur parasysh se vepra penale është në një ambient ku ka mundur të rrezikohej edhe mirëqenia e personave të tjerë të pranishëm.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumën prej tetëqind (800) euro për veprën penale të përshkruar si në piken I të dispozitivit, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve për veprën penale të përshkruar si në piken II të dispozitivit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ka aplikuar dispozitat e nenit 49 par 2 të KPRK-së e lidhur me dispozitat e zbutjes së dënimit ashti siç është përcaktuar me nenin 71 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin

e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Urdhrin për konfiskimin e armës gjykata e ka marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.06/2025, datë 07.02.2025

GJYQTARI

Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.